



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIA DEVELOPMENT FUND

RELACION TEKNIK

MBI PROJEKT PREVENTIVIN E PUNIMEVE SHITESH

**OBJEKTI :“Rikonstruksion i rruges Shkoder – Velipoje,
(Segmenti Harku Berdices – Baks), Loti 3 Pik. 430-774, Km
10+245-18+311”**

RELACION ARGUMENTUES TEKNIKO - EKONOMIK LIDHUR ME PROJEKT PREVENTIVIN E PUNIMEVE SHITES QE DUHET TE KRYHEN PER ELIMINIMIN E RESHQITJES DHE PER PERFUNDIMIN E OBJEKTIT.

“Rikonstruksion i rruges Shkoder – Velipoje,(Segmenti Harku Berdices – Baks), Loti 3 Pik. 430-774, Km 10+245-18+311”

A. PERSHKRIM I OBJEKTIT

Objekti " **“Rikonstruksion i rruges Shkoder – Velipoje,(Segmenti Harku Berdices – Baks), Loti 3 Pik. 430-774, Km 10+245-18+311”** fiilon prane rruges hyrese te Dajcit dhe perfundon ne fshatin Baks. Shtresat rrugore te rruges do te rindertohen, ndersa gjurma e rruges kryesisht mbetet e njejte me permiresime te aksit dhe niveletes se rruges.

B. ZHVILLIMI

Punimet e ndertimit ne objektin **“Rikonstruksion i rruges Shkoder – Velipoje,(Segmenti Harku Berdices – Baks), Loti 3 Pik. 430-774, Km 10+245-18+311”** kane filluar ne baze te kontrates se sipermarrjes midis operatorit Ekonomik (Kontraktorit) Shoqerise Ndertuese **“ALB TIEFBAU & PE-VLA-KU ”** shpk dhe Autoritetit Kontraktor FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT.

C. PARASHTRIMI PROBLEMATIKAVE

Gjate inspektimeve te fundit te kryera ne terren, per azhornimin perfundimtar te objektit, jane konstatuar disa demtime te rruges. Me konkretisht jane krijuar disa çarje gjatesore te asfaltit dhe bankines se rruges, nga pg.: 13+900 deri pg.:13+920 dhe nga pg.:14+060 deri pg.: 14+280. Perkatesisht ne zonen e pare çarja eshte e vogel , gjatesore ne nje gjatesi prej 3m dhe gjeresi 3 deri 4 mm . Kjo zone per momentin nuk eshte shume e dukshme, por nuk jep garanci per te ardhmen. Ne zonen e dyte, keto çarje jane me te dukshme, me gjatesi nga 1 deri 5 m dhe gjeresi nga 1 deri 4 cm. Ne zonen e dyte, thellesia e çarjes duket te jete e thelle dhe le te kuptojme se kemi te bejme me nje rreshqitje te trupit te rruges ne zonen ku bashkohet zona e malit me zonen e kenetes. Per momentin keto demtime nuk e cenojne qarkullimin normal te automjeteve dhe nderkohe firma kontraktuese do te marre masa per pershtatjen e sinjalistikes ne kete zone.

Nga demtimet e fundit, perfundimisht konstatohet se ndertimi i trupit te rruges ne kete zone kerkon nje nderhyrje te re dhe radikale. Duhet gjetur nje zgjidhje perfundimtare, pasi ne kete zone gjysma e trupit te rruges kalon ne zonen shkembore dhe gjysma tjeter mbeshtetet ne zonen kenetore duke e bere te paqendrueshme rrugen ne kete zone. Fillimisht do te behet nje studim me i hollesishtem gjeologjik i cili do te jape rekomandimet e duhura per zgjidhjen me te mire dhe me ekonomike te mundshme.

Gjithashtu ne baze te konstatimeve dhe kerkesave te OSHEE, dt 16.10.2018 nga prog 17+098 deri prog 17+156, linja e tensionit te larte nuk ka lartesine e duhur nga rruga, kjo per shkak te rritjes se kuotes se rruges ne kete pjese te segmentit.

Foto te bera ne objekt qe paraqesin carjet e ndodhura ne trupin e rruges







D. PARASHTRIMI I ZGJIDHJEVE TEKNIKE

Ne baze te perfundimeve te dala nga raporti gjeologjik te kryer nga shoqeria “NORD-COMAT” shpk rezulton se reshqitja ka ndodhur si pasoje e mbeshtjetjes se njerës ane te trupit te rruges ne shtresa lymore me torfe me veti shume te dobta dhe anës tjetër mbi formacione gelqerore me veti shume te mira fiziko mekanike . Gjithashtu sipas ketij raporti niveli I ujrave nentokesore është afer sipërfaqes dhe depozitimët kenetore janë te mbuluara ne uje duke ndikuar negativisht ne qendrushmerine e trasese se rruges.

Ne keto kushte dhe sipas rekomandimeve te raportit zgjidhja me e mire tekniko ekonomike është spostimi i aksit ne drejtim te malit ne bazament te qendrueshem. Gjithashtu do te kryhen edhe punime per spostimin e linjes elektrike te tensionit te larte sipas kerkeses se OSHEE

Per eliminimin e reshqitjes dhe spostimin e linjes elektrike te tensionit te larte do te kryhen keto punime.

1. PUNIME TE NDRYSHME (PRISHJEJE,CMONTIME,SPOSTIME ETJ)

Ne kete kapitull perfshihen punimet per prishjen e mureve te betonit ekzistues, bordurave dhe kunetave si pasoje e spostimit te aksit te rruges. Ketu është perfshire dhe spostimi I linjes elektrike te tensionit te larte qe parashikon vendosjen e dy shtyllave te reja dhe punimet perkatese.

2. PUNIME GERMIM-MBUSHJE NE RRUGE

Spostimi i aksit nga ana e malit shoqerohet me punime germimi shkemb i forte me makineri dhe tansport materiali te germuar per hapjen e trasese se rruges.

3. PUNIME SHITESASH NE RRUGE

Parametrat e rruge dhe shtresat rrugore nuk ndryshojne nga projekti baze dhe do te jene me paketen

Shtrese zhavori 2x20cm

Shtrese stabilizanti 1x15cm

Shtrese binderi 1x6cm

Shtrese asfaltobetoni 1x4cm

Spostimi do te behet nga Pg.: 13+902 deri Pg.: 14+395.

4. PUNIME NE VEPRA ARTI

TOMBINOT RRETHORE

Si pasoje e spostimit te aksit lind nevoja e zgjatimit te dy tombinove ekzistuese me d- 100 cm dhe pusetave te betony perkatese

NDERTIM MURE BETONI C20/25

Si pasoje e lartesis se madhe te skarpates lind nevoja e ndertimit te mureve prites betoni dhe kunetave perkatese nga ana e malit.

5. PUNIME PER SINJALISTIKE

Punime te nevojshme te sinjalistikes jane vetem vizimi i segmentit te rindertuar pasi tabelat rrugore dhe parmaket metalike vetem do te spstohen.

Kosto e punimeve shtese sipas tabelës se llogaritjeve tejkalojne vleren e parashikuar ne kontraten baze, prandaj per perfundimin e punimeve sipas kerkesave teknike duhet nje shtese kontrate me vlere **69 260 579 lek pa tvsh**. Cmimet jane sipas kontrates baze dhe per zerat e rinj te punimeve jane bere analizat teknike sipas manualit te cmimeve te vitit 2015, si dhe duke bere zbritjen sipas uljes ne perqindje te ofertes nga kontraktori.

Ne si mbikqyresi i objektit bashke me entin kontraktor per ç'ka dhe per cfare pershkruam me larte kemi pregatitur materialet perkatese teknike konforme kekesave te ligjit 8402 Dt 10/09/1998 i ndryshuar "Per kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve ne Ndertim" i cili percakton qarte pergjegjesite dhe detyrat e çdo aktori ne sipermarrje.

Ju falenderojme per bashkepunimin,

Mbikqyresi i Punimeve
Shoqeria "Zenit CO, Derbi-E" sh.p.k.
Administrator
Ing. Arqile PERI